



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.09.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për inspektimin financiar publik”.
3. Projektligji “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Anila Agalliu, Silva Caka, Tom Doshi

Të ftuar:

Erion Luçi – zëvendësministër i Financave

Kesjana Halili – drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese

Ilir Meçe – drejtor i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Atëherë, fillojmë mbledhjen e komisionit meqenëse edhe kuorumi i nevojshëm është bërë.

Në rendin e ditës së sotme kemi dy projektligje, për të cilat iniciuese është Ministria e Financave, dhe janë projekte të sjella nga qeveria.

Projektligji i parë është “Për inspektimin financiar publik”, si dhe projektligji i dytë është “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Për të paraqitur projektet e qeverisë është i pranishëm zëvendësministri i Financave, zoti Erion Luçi.

Faleminderit!

Po ashtu kanë ardhur: zonja Kesjana Halili, drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese; zoti Ilir Meçe, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik.

Fillojmë me projektin e parë.

Ju lutem, na bëni një paraqitje të përmbledhur të projektit, për shkak se është i njohur, dhe pastaj vazhdojmë me procedurën që e shoqëron.

Zoti Luçi, keni fjalën.

Erion Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Inderuar zoti kryetar,

Dua t’i bëj një parashtrim të dy ligjeve, sepse janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, në aspektin e funksionit që kanë për mirëmenaxhimin e financave publike. Këto janë dy ligje shumë të rëndësishme, që sigurojnë pikërisht përdorimin me eficiencë dhe monitorimin e fondeve, ashtu siç ju dhe parlamenti miratoni buxhetin në fillim të vitit. Është linja e parë e mbrojtjes që ka administrata publike për të mbajtur rigorozitetin ndaj zbatimit të ligjeve financiare të vendit.

Këto janë ligje që ndërveprojnë shumë me njëri-tjetrin, sidomos ligji i inspektimit financiar merr një informacion shumë të rëndësishëm nga auditivi. Dua të theksoj që ligji i parë i auditimit është një ligj shumë i rëndësishëm, që me kalimin e kohës, në praktikë, po mundohet që të bëhet më i dobishëm për menaxherët, që të përmirësojnë *output*-in në përdorimin e fondeve të tyre. Deri tani ligji i auditimit është përdorur më shumë si ligj inspektimi financiar, ligj kontrolli,

ndërkohë që edhe fjala “auditim” që është mbajtur, që nuk është tamam- tamam shqipe, është mbajtur në këtë gjuhë për të treguar atë praktikë që tani është gjerësisht e përdorur në vendet e Komunitetit European, për të vënë theksin mbi performancën, jo thjesht mbi penalizimin e zbatueshmërisë të ligjit dhe të buxheteve të ndryshme që kanë vende të ndryshme.

Në aspektin më të detajuar të ligjit “Për inspektimin financiar publik”, ky është një ligj i rëndësishëm. Do të jap thjesht disa nga fjalët kyçe dhe pastaj mund të kalojmë në detaje, nëse ka nevojë për pyetje. Është një ligj në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit të vitit 2015-2017. Pra, është një ligj i rëndësishëm për luftën kundër korrupsionit dhe rekomandimeve të Bashkimit European, sipas raportprogresit.

Duhet thënë që kjo e dyta ka qenë më nxitëse për lehtësimin e këtij ligji, por ky ligj mund të kthehet në një instrument zbatimi, domethënë mund të kthehet në një instrument të fort, pikërisht, për luftën kundër korrupsionit, që flitet shumë.

Një tjetër element i rëndësishëm i këtij ligji është përmirësimi ndaj ligjit të mëparshëm, i cili është miratuar në vitin 2010, por në zbatueshmërinë e atij ligji u pa se nuk pati atë lloj funksionaliteti dhe impakti që pritej. Një nga problemet e mosfunksionimit me eficiencë të ligjit të mëparshëm ka qenë pikërisht mospërfshirja e njësisë së inspektimit financiar, që është krijuar në Ministrinë e Financës në vitin 2011, në inspektimet në terren. Më përpara këto inspektime bëheshin me inspektorë që zgjidheshin në mënyrë rastësore dhe nuk kishin gjithmonë ato cilësi dhe ato përgjegjshmëri për të kryer inspektimet me eficiencë.

Ky ligj synon përgjegjshmërinë dhe ndjekjen e rasteve të raportuara për parregullsi, në zbatim të buxhetit, dhe të bëjë më përgjegjës kontrollin e njësisë qendrore. Në anën tjetër, rrit edhe kapacitetet profesionale të inspektorëve nëpërmjet trajnimeve të përhershme, por, e theksoj, edhe përgjegjshmërinë e strukturave të përfshira në inspektimet financiare, të cilat tani do të jenë në varësinë e njësisë së inspektimit financiar, që është në Ministrinë e Financës, dhe jo të pavarura ose të pakontrolluara nga kjo njësi.

Një element tjetër i rëndësishëm i këtij projektligji, është përfshirja e AFCOS-it që është një modul shumë i rëndësishëm, të cilin Bashkimi European dhe Komisioni European e kërkojnë për disbursimin e fondeve të tyre IPA. AFCOS-i është një rrjet raportimi dhe ndjekje e parregullsive në përdorimin e Fondeve IPA, që është i ngjashëm me inspektimin financiar që ne kemi për fondet tona publike, vetëm se ata i kërkojnë që të jetë paralele. Ky është një shembull i mirë sesi praktikat më të mira zbatohen në ndjekjen e fondeve.

AFCOS-i ka një sërë elementesh, që nga rrjeti i raportuesve deri te mënyra sesi ndiqen parregullsitë dhe sesi institucione të ndryshme bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, ILDKP-në ose dhe të tjera për hetimin, ndjekjen dhe inspektimin e rasteve të ndryshme.

Fusha e zbatimit është e ngjashme me fushën e zbatimit të ligjit të më pashtëm. Pra, janë të gjitha ato njësi, të cilat përdorin fonde buxhetore dhe ato njësi që përdorin fonde të Bashkimit Europian, IPA. Kështu që pak a shumë janë të gjitha njësitë e qeverisë qendrore dhe ato lokale përfshihen në këtë ligj.

Një tjetër element i rëndësishëm, që desha të theksoja, është fakti se ky është një ligj i bërë me një bashkëpunim shumë të ngushtë me SIGMA-n, që është një ndër agjencitë që BE-ja dhe Komisioni Europian i përdorin gjerësisht për progresimin e ligjeve dhe ka marrë dakordësinë edhe të Drejtorisë së Buxhetit në Komisionin Europian, *DG BUDGET*. Kështu që ky është një ligj që i ka kaluar të gjitha këto filtra, përveç konsultimit të gjerë me të gjitha njësitë e tjera, duke filluar nga ministratë tjera, me Ministrinë e Drejtësisë etj.

Unë nuk po zgjatem më shumë me detaje, sepse ligji në vetvete është i qartë në aspektin e relacionit, por thjesht do të theksoja që një ndër orientimet kryesore të ndryshimit të këtij ligji ka qenë bërja më efektive e inspektimit. Ne, pas miratimit të këtij ligji, nëse miratohet nga parlamenti, do të bëjmë të gjitha përpjekjet tona për të rritur herë numrin e inspektimeve dhe për të rritur efektivitetin rezultateve të marra nga këto inspektime, që për momentin janë duhet thënë jo të kënaqshme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti zëvendësministër, për ekspozenë shumë të qartë që i adresuat komisionit!

Mund të vazhdojmë me procedurën.

Zoti Fino, në cilësinë e relatorit, a keni ndonjë koment të përgjithshëm?

Bashkim Fino – Komentin e përgjithshëm e keni të shpërndarë në relacionin që kam shpërndarë, është brenda kuadrit kushtetues. Ky është një ligj që ka ardhur pas vitit 2010, siç tha edhe zëvendësministri, por për të qartësuar kolegët dhe veten do desha të bëja dy-tri pyetje për të hyrë pastaj në shqyrtimin nën për nën.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Bashkim Fino – Zëvendësministrin tha se është bërë efektiv inspektimi i Ministrisë së Financave, deri tani nuk ka qenë efektive.

Unë kam një pyetje: a ekziston rreziku i dublimit dhe i mbivendosjes së kompetencave në njësitë e Inspektoratit Financiar me Kontrollin e Lartë të Shtetit?

E dyta, ku qëndron ndryshimi me procesin e auditimit që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit me kontrollin e brendshëm financiar publik? Këto janë dy gjëra që nuk më shkojnë.

E treta, a do të kryhet inspektim financiar sipas projektligjit, edhe për buxhetin gjyqësor dhe prokurorinë, pushtetin vendor, pra ndarja e pushteteve, sepse ne jemi Komision i Ligjeve këtu dhe duhet respektuar ndarja e pushteteve? gjithsesi, unë po e bëj si pyetje: a do të kryhet inspektim financiar për prokurorinë, për gjyqësorin dhe për pushtetin vendor?

Pyetja e fundit që kam, ju e prekët shkarazi pak, por unë do të doja një informacion më të detajuar jo vetëm nga ju, por edhe nga të tjerët që kemi këtu prezent, pfarë nuk ka funksionuar në ligjin nr. 10294 të vitit 2010, që kaq shpejt, në brenda 4 vjetësh, sjellim një ligj “Për inspektimin financiar për ta bërë të ri? Ndërkohë, po t’i lexosh të dyja ligjet ka vetëm disa korrigjime të vogla, siç thonë ju, që do të merret tani për t’u bërë më efektiv inspektorati nga Ministria Financave.

Në qoftë se, zoti kryetar, këto katër pyetje që bëra unë gjejnë përgjigjen e saktë, atëherë mendoj se mund të kalojmë pastaj në shqyrtimin nen për nen, për të diskutuar projektligjin përkatës.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Zoti zëvendësministër, keni fjalën.

Erion Luçi – Faleminderit!

Janë pyetje me shumë vend dhe ndihmojnë edhe për të sqaruar frymën, me të cilën reforma në menaxhimin e financave publike po synon dhe po mundohet që të modernizoj sistemin e auditimit dhe të kontrollit, që janë dy gjëra deri diku të ndryshme. Pikërisht te kjo diferenca ndërmjet auditimit dhe inspektimit duhet të jemi të kujdesshëm.

Në lidhje me pyetjen e parë, që t’i qëndroj rendit të pyetjes, pra të dublimeve me Kontrollin e Lartë të Shtetit si auditim, e thashë edhe më parë, është linja e parë e mbrojtjes për drejtuesit e institucioneve për të mbrojtur zbatueshmërinë e ligjit. Për shembull, KLSH-ja është pas fakteve, ndërkohë që inspektimi financiar, në këtë rast është auditimi ai që është më aktiv, bën që edhe gjatë zbatimit t’i qëndrojmë ligjit dhe ka një intensitet më të madh në mbikëqyrjen e aktivitetit. Për shembull, do ta shikojmë te ligji i dytë i auditimit, është shtrirë në të gjitha njësitë e zbatimit të buxhetit që ta kapim në kohë. KLSH-ja mund ta kapë pas një viti dhe nuk është gjithëpërfshirëse, ndërkohë që këto janë struktura gjithëpërfshirëse, mbulojnë të gjitha fondet.

Edhe një herë, janë në funksion të drejtuesve të institucioneve, jo në funksion, të themi, të parlamentit, kurse KLSH-ja shtënë parlamentin, për t'i dhënë parlamentit atë siguri, që quhet katër sy, përveç syve që ka çdo institucion, kemi dhe dy sy të tjerë, që është një parim bazë i menaxhimit të fondeve publike që ju të keni sigurinë për përdorimin saktë të fondeve publike. Kështu që dublimi nuk është tamam-tamam dublim, por është pikërisht parimi i katër syve ose diçka më shumë.

Për pyetjen e dytë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe inspektimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të fokusohet tamam tek auditimi, nuk e ka rolin e inspektimit, megjithëse Iliri mund të më korrigjoj te kjo pikë, por kam përshtypjen se është thjesht te pjesa e parë, që të japë sigurinë e arritjes së objektivave që i vihen buxhetit në fillim të vitit dhe jo inspektimit. Kështu që në këtë rast inspektimi është pikërisht një ndjekje e gjetjeve, që mund të ketë gjatë procesit të auditimit, por edhe të raportimit nga njësi të ndryshme, që nga Presidenti deri te njësi të tjera, që shikojnë veprimtarinë publike. Kështu që, në këtë aspekt, edhe këtu ,nuk ka përplasje me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Për sa i përket fushës së mbulimit, po, janë përfshirë të gjitha ato institucione që përmendët, edhe prokuroria, edhe gjyqësori, edhe të gjitha, sepse janë të gjitha që bazohen në fonde buxhetore. Por këtu nuk diskutohet parja komplet e aktivitetit të tyre, është pjesa financiare e aktivitetit të tyre, si bëhet përdorimi i fondeve që vihen në dispozicion të këtyre institucioneve, përfshirë dhe parlamentin, për kryerjen e aktivitetit përkatës, në mënyrë joabuzive ose jo të ç'rregullt në aspektin e ligjit. Kështu që çdo para e taksapaguesve është subjekt i këtij inspektimi.

Çfarë nuk ka funksionuar deri më sot? Unë mundova ta theksoja edhe më përpara, është fakti që mënyra sesi është zbatuar ligji ka qenë deri diku rastësore. Domethënë, njësia që u krijua pas ligjit të vitit 2010 pati një rol më shumë koordinues për krijimin të themi rrjetit dhe më pas edhe të nxitjes së këtij rrjeti për t'u aktivizuar në aspektin e inspektimeve, por eksperiencia e deritanishme rezultoj se pa përfshirjen e drejtpërdrejt të kësaj njësie, që ka përgjegjësin të drejtpërdrejtë për realizimin dhe zbatimin e këtij ligji te njësitë e inspektimit në institucione të ndryshme, nuk ka një përgjegjshmëri të atillë që çon në një zbatim efektiv të ligjit.

Ligji i ri, si ndryshim thelbësor, ka pikërisht këtë përfshirje të njësisë së inspektimit, e cila mendohet të fuqizohet akoma më tepër në të ardhmen, edhe për faktin që duhet të marrin përsipër elementin e dytë, që është i rëndësishëm në këtë ligj, atë që quhet AFCOS, që është moduli që neve na duhet për të siguruar Komisionin European, që çdo fond që ne marrim nga ata zbatohet

dhe shpenzohet në një mënyrë të rregullt, brenda procedurave që ka BE-ja. Me fuqizimin e kësaj njësie në presim, pikërisht, që ky ligj të fillojë të zbatohet në mënyrë më rigoroze, në aspektin e ndjekjes së rasteve ose parregullsive, që ne i quajmë, të zbatimit të shpenzimeve ose të ligjeve të financave publike.

Nuk e di, nëse isha i qartë te këto pika.

Fatmir Xhafaj- Në rregull.

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Në vijim edhe të pyetjeve që u bënë më parë nga relatori, dua të di: sa është konsultuar ky projektligj me institucione të rëndësishme, siç është Kontrolli i Lartë i Shtetit? Nëse është konsultuar, cili është mendimi i tyre formal, zyrtar në lidhje me këtë? Sigurisht, edhe unë ndaj mendimin që është shumë e rëndësishme të ndahen fushat qartë që të mos ketë konflikt kompetencash. Mund të bëjnë të njëjtën punë, por qëllimet duhen të jenë të ndryshme.

Sigurisht, nuk është thjesht parimi i katër syve, është një koncept i ndarë midis kontrollit të brendshëm dhe kontrollit të jashtëm. Ku kontrolli i jashtëm duhet të jetë i pavarur dhe ne e kemi të rregulluar me Kushtetutë. Kështu që mendimi i tyre është shumë i rëndësishëm për të parë se çfarë thonë ata. Pra, dua të di: a është bërë kjo konsultë dhe nëse po, cili është qëndrimi i tyre formalisht, sepse ne nuk e kemi këtu?

Gjithashtu, ju përfshini në subjektet e këtij inspektimit financiar publik edhe OJF-të. Sigurisht që kanë një rol shumë të rëndësishëm në shoqëri dhe mund të qëllojë që të marrin dhe fonde nga shteti, nëpërmjet këtij fondi specifik që ka shteti për veprimtarin e tyre, por mund të marrin fond edhe nga Bashkimi Europian. Nuk e di nëse edhe këto fonde do t'i ekspozojnë ato si subjekte ndaj këtij kontrolli. Duke qenë se janë një institucion shumë i rëndësishëm kontrolli mbi qeverinë, është e rëndësishme që inspektimi financiar mos të jetë një element kontrolli dhe presioni mbi to. Për rrjedhojë dua të di: a janë bërë konsultime publike me to? Kur janë bërë, sa janë bërë dhe cilat janë konkluzionet e këtyre konsultimeve? Pra, çfarë mendon shoqëria civile për këtë ligj, i cili do t'i kontrollojë ata në punën e tyre? Sigurisht, unë besoj se është shumë i rëndësishëm integriteti i tyre, sepse dhe aty ka korrupsion. Por çfarë mendojnë në aspektin e raporteve me qeverinë?

Ju thatë që subjekti do të jetë edhe pushteti gjyqësor edhe prokuroria. Në mënyrë të shprehur unë këtu nuk e shoh, vetëm në qoftë se është termi “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që sipas terminologjisë kanë të njëjtin kuptim me përcaktimin e ligjit dhe menaxhimit të sistemit buxhetor, nëse është këtu.

Për shkak të rëndësisë që ka si sistem, po të themi si pushtet i pavarur, duke qenë se pavarësia financiare është pjesë e pavarësisë të institucioneve, kjo do të thotë jo vetëm të japësh para nga buxheti i shtetit mjaftueshëm për të kryer punën e tyre, por edhe të jesh i limituar në kontrollin që i bën, për rrjedhojë duke qenë se këtu është shumë e fshehtë përfshirja e tyre, nëse është kështu siç thoni ju, por këtu nuk lexohet, a jeni konsultuar me ta? Pra, a jeni konsultuar me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, a jeni konsultuar me prokurorin e Përgjithshëm, i keni marrë opinionet e tyre? Cili është opinionin e tyre mbi këtë, formalisht me shkrim, sepse nuk e kemi, për të parë nëse ata kanë probleme në lidhje në konceptin që ka qeveria për inspektimin e tyre? Sepse, siç kuptoj unë nga ligji, është një strukturë e centralizuar nën komandën e ministrit të Financave.

Fatmir Xhafaj - Po kështu ka qenë kjo, more zotëri!

Oerd Bylykbashi - Në rregull, nuk kam problem për këtë gjë, kështu është mirë që të jetë, nuk mund të jetë në dorën e çdo ministri.

A i keni marrë mendimet e sistemit të drejtësisë, të gjyqësorit dhe prokurorisë për këtë lloji, po themi, ndërhyrje të ligjshme në funksionimin e atij pushteti?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull, vetëm ju lutem, na i sqaroni pak këtë punë. Ky është një ligj që ka ekzistuar, ju thjesht po e sillni si një ligj të ri me ndryshime, apo?

Erion Luçi – Saktë, fusha e veprimit nuk ka ndryshuar.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kam merakun unë, kolegut përgjigjuni një për një, të gjitha pyetjeve, siç ju përgjigjët kolegëve paraardhës, vetëm të sqarohemi për efekt të opinionit publik kam merak.

Erion Luçi - Fusha e veprimit nuk ka ndryshuar, kështu që është e ngjashme me ligjin e parë, ne thjesht e qartësuam pak më shumë këtë fushë veprimi. Por, më falni për përsëritjen, por ideja është që çdo lloji shpenzimi publik është subjekt i mbikëqyrjes nga ministri i Financave, sepse për këtë punë është Ministria e Financave, për të parë që të gjitha ligjet, që janë të miratuara nga parlamenti, dhe rregulloret në ligje që janë më pas zbatohen në mënyrë rigoroze. Pra, qëllimi i këtyre nuk është për t'u imponuar këtyre institucioneve ndonjë politikë të caktuar, por për të parë

që ata janë në të njëjtën linjë me zbatueshmërinë e ligjit të financave publike. Për shembull, nëse ne themi që një institucioni të caktuar, nuk dua të përmend këtu emra domosdoshmërisht, i është thënë në fillim të vitit që do të blejë 5 makina dhe pastaj ata zbulojmë që ata nga 5 me të njëjtin fond kanë blerë tre makina, ai është një subjekt që mund të lindë natyrshëm. Flasin për këtë lloji kontrolli, nuk po flasin për një kontroll, për shembull, që të shkojmë pa arsye, se ky është një tjetër aspekt i inspektimit financiar, nuk është një inspektim që bëhet si auditivi, që është në mënyrë më të rregullt, bëhet thjesht në rast se ka evidencë dhe sinjalizim të saktë. Për këtë ka dhe një filtër, nuk është çdo rast i mundshëm. Në qoftë se janë blerë 5 makina, nuk niset rasti, ose dhe kur janë blerë tre makina, por që ka një justifikim të saktë, përsëri nuk niset rasti. Flasin për një rast që me të vërtetë, edhe në bazë të praktikave të mira të BE-së, sepse kjo është një tjetër element që do ta ndihmojë njësinë për shembull, që do të bëhet në paralele me zbatimin e AFCOS-it, që ka dhe disa prime dhe praktika të mira për sa i përket mënyrës sesi klasifikohen rastet, që quhen jo të rregullta. Kështu që flasin për një kontroll s'do të thosha të kufizuar, por brenda këtyre kontureve që ka fryma e ligjit të financave publike.

Pra, në qoftë se biem dakord që shpenzimet do të shkojnë në këtë drejtim, ne thjesht mundohemi që të sigurohemi që shpenzimet me të vërtetë shkojnë në atë drejtim që ramë dakord dhe nuk ka një shmangie nga nisja fillestare e këtyre shpenzimeve.

Për sa i përket Kontrollit të Lartë të Shtetit ose mbivendosjes së punës, Kontrollit të Lartë të Shtetit i është marrë të themi mendim patjetër dhe ne kemi një bashkëpunim të mirë me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kontrolli i Lartë i Shtetit e mbështet këtë lloji forcimi të auditimit të brendshëm, sepse ata bazohen në një pjesë jo të vogël të punës së tyre mbi gjetjet e auditimit të brendshëm për të bërë dhe ndjekjen e tyre të punës. Edhe inspektimi financiar bazohet në gjetjet e auditimit të jashtëm të KLSH-së, pikërisht për të ndjekur disa nga rastet që KLSH-ja i nxjerr si të parregullta. Domethënë, ka dhe këtë lloji burimi informacioni për ta ndjekur. Gjithashtu, ka dhe opinionin e KLSH-së, që është pozitiv për ligjin, edhe për faktin që njësi që na ndihmon për përmirësimin e këtij ligji, është e njëjta njësi që i ndihmon në përgjithësi për këto institucione, përfshirë dhe KLSH-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket gjyqësorit dhe prokurorisë, është marrë dhe mendimi i Ministrisë së Drejtësisë, i prokurori i Përgjithshëm dhe gjithë kanë qenë pozitiv për këto ndryshime të ligjit.

Për sa u përket OJF-ve, për sa kokë që objekti i ligjit është thellësisht te qeveria qendrore, është një pikë e rëndësishme ajo që thatë ju dhe ne e vlerësojmë që mund të kishte dhe disa konsultime. Po këtu gjithmonë flasim për disa financime që vijnë nëpërmjet fondeve IPA dhe është një kërkesë e fondeve IPA se sa buxhetorëve për të ndjekur këto raste. Për shembull, edhe OJF-të, të cilat marrin ose përfitojnë nga fondet IPA, të kenë një farë kontrolli në aspektin e përgjegjshmërisë së tyre në zbatimin e këtyre. Por nuk diskutohet në asnjë rast, për shembull, që prapë ne të shkojmë te OJF-të në mënyrë independente, duhet të ketë patjetër një raportim, që të jetë brenda këtyre kriterëve dhe standardeve që diskutuam, për të bërë inspektimin e asaj njësie, ose saj OJF-je, të vlefshme për inspektimin financiar, gjithmonë brenda atyre fondeve që kanë lidhje të ngushtë me fondet IPA ose me fondet e buxhetorit, nëse janë përfshirë fonde buxhetore, dhe jo për gjithë veprimtarinë e OJF-ve.

Në asnjë rast nuk tejkalohen objektivat, për të cilat fondet fillestare janë dhënë. Domethënë, në qoftë se ne i kemi një OJF një fond për të bërë fletë shpërndarje për fushatën kundër informalitetit, të themi, ne i shikojmë vetëm për atë lloji, nëse themi që ajo punë është kryer saktë apo nuk është kryer. Nëse ajo e ka shumë më të gjerë si pamje, si veprimtari, veprimtaritë e tjera të këtyre OJF-ve nuk kanë të bëjnë. Edhe në këtë rast kërkohet një dëmshpërblim, nuk kërkohet ndjekje, megjithëse ka dhe raste tjera që mund të shkojmë në prokurori e tjera. Por flasim gjithmonë brenda një ndjekjeje dhe një inspektimi që siguron të paktën mbarëvajtjen e përdorimit të fondeve publike. Pra, e theksoj edhe një herë, është një mjet që neve na duhet për të krijuar disiplinën në zbatimin e buxheteve të këtyre njësive me fonde publike.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Meqenëse se ju këto dokumente i keni, pra konsultat, opinionet nga Prokuroria, nga KLD-ja besoj, nga KLSH-ja, kuptova që nuk keni konsultime me OJF-të, por të paktën disa nga ato, do të ishte mirë t'i vihen në dispozicion anëtarëve të komisionit, zoti kryetar, në mënyrë që të kemi një ide të qartë se për çfarë flasim, për të parë dhe opinionin pozitiv, mund të ketë dhe diçka tjetër që mund të na interesoj.

Ju, gjithashtu, thoni se subjekti i kontrollit do të jetë çdo person fizik apo juridik vetëm për fondet, neni 4, pa hyrë te detaji i nenit. Dua të kuptoj: ju do të shkoni të kontrolloni, të bëni inspektim të veçantë? Pra, ju do të kontrolloni në mënyrë të veçantë çdo subjekt fizik apo juridik, i cili ka përfituar fonde nëpërmjet shtetit? Si e mendoni ju këtë?

Ekzistojnë struktura të tjera, për shembull ka një departament antikorupsion pranë Kryeministrit, i cili bën gjithashtu kontrolle. Si e koordinon ky ligj dhe si e disiplinon këtë?

Erion Luçi – Dhe një herë e theksoj, ato janë vetëm për atë pjesë të aktiviteteve që lidhen me fondet publike, domethënë çdo person juridik, jo për gjithë aktivitetin e tyre. Nuk ka asnjë të drejtë. Edhe për qeverinë qendrore, nuk diskutohet që të shikohet komplet ministria ose komplet, të themi, njësia përkatëse, diskutohet vetëm ai aktivitet i veçantë. Është shumë i përcaktuar dhe i fokusuar.

Për ndarjen e këtyre opinioneve të secilës nga njësitë ne do t'ju lëmë relacionin që është dërguar në qeveri, ku ka gjithë këtë pjesën.

Fatmir Xhafaj – Pyetje të tjera?

Arben Ristani – I gjithë procesi synon, sigurisht, që të miradministrojmë fondet publike dhe është vërtetë e rëndësishme që paratë që u marrim shqiptarëve nëpërmjet taksave t'i administrojmë mirë dhe t'ua kthejmë atyre në benefite për jetën e tyre të përditshme. Pikërisht për të realizuar këtë krijojmë mekanizma të tilla, si kontrolle të jashtme dhe kontrolle të brendshme, prokuroria, policia, mekanizma të shumtë, në mënyrë që, të paktën me ligj, të miradministrojmë fondet publike, pra, logjik të fundit, paratë e shqiptarëve. Sigurisht që reformat në këto pjesë janë të mirëpritura, në mënyrë që të kemi ligje sa më të mira. Por theksoj se Akilit apo çelësi i gjësë vjen pikërisht te përgjegjshmëria e njerëzve, të cilët zbatojnë ligjin dhe bëjnë të mundur mirëmenaxhimin e fondeve publike. Kur vjen çështja te përgjegjshmëria, unë personalisht jam pak skeptik kur shikoj sesi ente publike të tilla, si ministrit apo thesari i shtetit, përdoren për të kaluar para në favor të partive politike pa ligj, siç është rasti i fundit, ku Ministria e Bujqësisë apo Ministria e Turizmit, nëpërmjet thesarit të shtetit, kalojnë fonde për partitë politike, jashtë fondeve të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo fondet që ligji ka përcaktuar për partitë politike. Ky është një keqpërdorim dhe papërgjegjshmëri në mënyrën sesi i trajton institucionet shtetërore, si trajton ministrin, si trajton thesarin e shtetit në rastin konkret.

Për më tepër, jam skeptik pikërisht te kjo përgjegjshmëri kur shikoj që Kryeministri i vendit tim ka një pasuri të padeklaruar dhe të vjedhur praktikisht prej 200 milionë eurosh, që i ka marrë pikërisht nga fondet e shqiptarëve, taksapaguesve. Pikërisht, këto fonde publike që ne duam të mirëmenaxhojmë praktikisht krijuakan të çara të tilla, që i dhënkuan mundësi Kryeministrit të ketë 200 milionë euro dhe këtu pastaj përgjegjshmëria është në fundin e saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flas për institucione serioze, siç është OSBE-ja. Pra, në këto kushte të krijosh nga fondet publike pasuri të tilla, prej 200 milionë eurosh, tregon që përgjegjshmëria e këtyre njerëzve që punojnë në administratën publike është zero, për më tepër është dashakeqëse. Janë aty, jo për të qenë të përgjegjshëm për të mirëmenaxhuar fondet publike, por t'i vjedhur ato dhe për të krijuar pasuri të tilla në kurriz të shqiptarëve.

Kështu që, sado të bëjmë ligje të mira, në rast se nuk largojmë nga drejtimi njerëzit e papërgjegjshëm, për më tepër njerëzit hajdutë, njerëzit që duan t'i vjedhin pasuritë e këtij vendi, nuk do të dalim atje ku duhet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Diskutime të tjera ka?

Urdhëroni, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë nuk do të bëj diskutim politik, por po deshe edhe mund ta bëj. Pyetjet i bëra, meqenëse jam edhe ekonomist, që të qartësoj edhe kolegët e mi, që çfarë është inspektimi, në fund të fundit, çfarë është Kontrolli i Lartë i Shtetit, sepse më pas kemi të bëjmë edhe me ligjin tjetër të kontrollit të brendshëm, që do ta miratojmë.

Doja t'u kujtoja kolegëve në tërësi që Ministria e Financave ka një ligj kuadër, i bërë në vitin 2008, që është ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” më 26.06.2008, që do të thotë se në këtë ligj kuadër nuk ndërhyhet shumë herë. Ai është një ligj udhëzues, frymëzues i Ministrisë së Financave në raport me të gjitha ministrinë e tjera.

Neni 66 thotë që ministri i Financave është përgjegjës për paraqitjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme ku përfshihen: Presidenti i Republikës deri tek institucionet më të vogla.

E lexova dhe e citova këtë ligj të rëndësishëm të bërë në vitin 2008 edhe me konsensusin tonë në atë kohë, që kemi qenë në opozitë, që do të thotë se ky është udhërrëfytyesi i Ministrisë së Financave, në rastin konkret, për menaxhimin e fondeve.

Inspektorati që po krijohet ka të bëjë, në fund të fundit, me ndërgjegjësimin, siç tha zëvendësministri, për ta bërë më efektiv këtë inspektorat dhe jo për të qenë inspektorat, le të themi, koordinues pranë zyrave për të bërë koordinime të ndryshme. Çfarë do të thotë ky inspektorat financiar? Ky inspektorit do të thotë që vihet në lëvizje vet, pa plan pune. Pra, vihet në lëvizje për të kontrolluar fondet e buxhetit të shtetit dhe fondet europiane, por nuk vihet në lëvizje vetë, por vihet në lëvizje edhe kur drejtuesit e institucioneve, siç e kam kuptuar unë projektligjin, kërkojnë

ndihmë nga ministri i Financave, për të bërë një kontroll të caktuar për një gjë të caktuar. Dhe kjo është një gjë shumë e mirë që ne bëjmë në ndryshimin e këtij projektligji, i cili nuk e kishte ligji i mëparshëm i 2010-s. Pra, jo pa qëllim i bëra ato pyetje, për t'i ardhur në ndihmë diskutimit tim.

Më duhet të them se ne i bëjmë ligjet shumë të mira, i bëjmë që t'i menaxhojmë mirë fondet e shqiptarëve dhe këtu nuk bëhet fjalë për papërgjegjshmërinë e njerëzve. Papërgjegjshmëria e njerëzve është në kutitë e votimit në vitin 2017, atëherë është koha dhe momenti që njerëzit të na votojnë për papërgjegjshmëri apo për ndershmëri të këtyre projektligjeve, që bëjmë ne apo të fondeve të caktuara. Prisni deri në atë kohë! Ndërkohë, ne po i rregullojmë ligjet tuaja, për t'i bërë më efektive, më të drejta, më kontrolluese, për të pasur më efekt kontrolli në sistemin financiar.

Prandaj, unë do të thosha, zoti kryetar ta miratojmë në parim. Kemi disa vërejtje të vogla, që mund t'i rregullojmë nen për nen që e keni në relacion dhe të vazhdojmë me projektligjin tjetër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim me diskutimet në parim.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka abstenim.

Miratohet në parim projektligji “Për inspektimin financiar publik”.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni 1 “Objekti i ligjit”. Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Dakord.

Miratohet.

Neni 2 “Misioni”. Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4 “Fusha e zbatimit të ligjit”. Kush është kundër? Abstenim? Dakord.

Miratohet.

Neni 5 “Përkufizime”.

Zonja Vasilika Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Nëse ju kuptova drejt, ju thatë se në fondet publike përfshihen fondet nga buxheti i shtetit dhe nga IPA. Ndërkohë që te përkufizimi ju keni futur të gjitha fondet, edhe të donatorëve të tjerë.

Është e saktë? Fjalën e kam për te shoqëria civile. Pra, nga njëra anë ju thatë që do të kontrollohen të gjitha fondet publike dhe fondet e Bashkimit European, ndërkohë këtu i keni përfshirë të gjitha fondet.

Fatmir Xhafaj – Një minutë, ju lutem!

Urdhëroni!

Erion Luçi – Pika 2 e nenit 5, sidomos pjesa e donatorëve të tjerë, ka lidhje ose kufizohet nga germa “c” e nenit 4, ku thuhet: “Për ata donatorë që kanë një marrëveshje ndërkombëtare”. Flasim për pjesën e donacioneve, që vazhdojnë të miratohen edhe nga parlamenti, për shembull, Banka Botërore, nuk po flasim për fonde që shkojnë drejtpërdrejt. Kështu që germa “c”, pak a shumë, e kufizon.

Fatmir Xhafaj – Po, ka ndonjë gjë tjetër për nenin 5?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Keni rregullimin nen për nen. Megjithëse keni bërë përpara, prandaj nuk po flas. Meqenëse e keni, unë nuk po ndërhyj.

Neni 4 ka një rregullim togfjalëshi, nuk kishte nevojë të flisja.

Neni 5, për shembull, përkufizimet duhen vendosur sipas rendit alfabetik. Ato janë çështje juridike. Në qoftë se e keni përpara relacionin sipas neneve, lexojini dhe ato që të mos flas unë në çdo kohë.

Fatmir Xhafaj – Te neni 4, ka disa zëvendësime fjalish. Ka probleme? Nuk ka probleme, besoj. Dakord.

Bashkim Fino – Iva, ju lutem, jepjani një kopje zëvendësministrit! Te neni 4, fjala “shtetërore” zëvendësohet me fjalën “tregtare”; fjala “pasurore” të zëvendësohet me fjalën...

Fatmir Xhafaj – Keni gjë? Në rregull me nenin 4? Besoj se çështje terminologjie.

Neni 5 “Përkufizimet”. Renditja është kërkuar të jetë sipas rendit alfabetik. Dakord.

Dakord me nenin 5.

Neni 6 “Parimet e inspektimit financiar publik”.

Është rekomandim do t’i thuhet. Dakord me rekomandimin: ‘Të vendosen parimet e Kodit të Procedurës Administrative...’

Dakord.

Neni 7 “Veprimtaria e inspektimit financiar publik”.

Po, në pikën 1, germa “a” saktësohet togfjalëshi: “si dhe dyshimet për mashtrimet e kryera”. Mund të na i saktësoni çfarë do të thoni me këtë? Te neni 7, germa “a”. Çfarë keni dashur të thoni me këtë?

Ilir Meçe – Germa “a” e pikës 1 në nenin 7 ka të bëjë me shkeljen e ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike, si dhe dyshimet për mashtrimet e kryera kur titullarët ose personat në organizatë, në institucion kanë dyshime konkrete për mashtrim mbi përdorimin e këtyre fondeve. Koncepti shtrohet që inspektimi kryhet vetëm mbi faktin, vetëm mbi parregullsinë dhe jo mbi të gjithë sistemin. Kjo është diferenca edhe në raport me KLSH-në.

Fatmir Xhafaj – Qartë kjo është fryma e ligjit, këtë e kuptuam.

Ilir Meçe – Dyshimi për mashtrim. Kur ka një sinjalizim për mashtrim, që dyshohet se ka ndodhur një mashtrim, në raport me ligjshmërinë e zbatimit të veprimit.

Fatmir Xhafaj – Është shumë e paqartë, le t’ia lëmë komisionit përgjegjës...

Ilir Meçe – Ai që bën sinjalizimin dyshon.

Fatmir Xhafaj- Mirë, pra, por s’mund të formulohet kështu, ka të drejta.

Nenin 7 t’ia kalojmë komisionit përgjegjës për të qenë i vëmendshëm.

Neni 8. Kush është kundër? Abstenim?

Dakord.

Neni 9 “Detyrimet e ministrit”.

Kush është kundër? Abstenim? Dakord.

Neni 10 “Të drejtat e ministrit”.

Po, mirë, nuk është ndonjë gjë kjo. Vazhdojmë.

Në rregull.

Neni 11 “Funksionet e nëpunësit parautorizues”.

Dakord. Hiqet fjala “vetëm”.

Bashkim Fino – Të bëj një ndërhyrje të vogël. Te neni 10, germa “b”, më tërheq vëmendjen diçka. Aty thuhet: “T’i propozojë Kryeministrit të ndërmarrë veprime të mëtejshme, të nevojshme kur individi përgjegjës është një ministër ose titullar i rëndësishëm së qeverisjes së përgjithshme”. E ka këtë tagër, këtë të drejtë ta bëjë Kryeministri, kur ju si inspektorit i jepni këtë gjë? Kam përshtypjen se e ka. Pse t’i propozojë Kryeministrit, sipas parimit të ndarjes ndaj pushtetit flas gjithmonë? Për shembull, ju bëni një kontroll te prokurori i Përgjithshëm, te gjykata e tjera, s’mund t’i propozoni Kryeministrit për këtë gjë, apo jo.

Fatmir Xhafaj – Vazhdoni ku e la, zoti Fino.

Ilir Meçe – Logjika është se Kryeministri ka të gjithë instrumentin që t'i drejtohet Kuvendit, në rastin nëse është prokurori i Përgjithshëm ose një titullar i një institucioni të pavarur, për të ndërmarr masat Kuvendi administrative, sepse bëhet fjalë gjithmonë kur çështja është administrative ose disiplinore dhe është Kuvendi që vendos, por Kryeministri merr iniciativën për ta përcjell në Kuvend, se nuk mund ta sjellë ministri i Financës në mënyrë të drejtpërdrejt kur konstatohet një parregullsi. Prandaj i është lënë Kryeministrit në qoftë se mendon ta përcjellë në Kuvend.

Fatmir Xhafaj - Qartësoheni këtë, sepse duhet “institucioneve përgjegjëse” kaq, pastaj është Kuvendi, është Kryeministri, është Presidenti, është prokurori, le t'ia lëmë institucioneve përgjegjëse, mos të përcaktojmë se mund të kemi këtu konflikt. Riformuloheni ju, Iva, dhe çojani komisionit. Në rregull.

Dakord me vërejtjen e zotit Fino me të dyja te neni 10.

Te neni 11, hiqet fjala “vetëm”. Në rregull.

Bashkim Fino – Dihet që vetëm për Bashkimin European, nuk e kemi fjalën për gjë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Qartë.

Neni 12.

Po, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 12 është ristrukturuar në krahasim me nenin e mëparshëm, njësia e përgjegjëse do të jetë drejtori?

E dyta, në ligjin e mëparshëm ka pasur disa kriteret specifike për zgjedhjen e drejtuesit. Krahas kriterëve të përgjithshme që përmban ligji i nëpunësit civil, ka pasur dhe kriteret specifike. Pse janë hequr në këtë projekt që keni sjellë?

Erion Luçi – Në përgjithësi është një praktikë që e kemi zbatuar dhe hasur edhe në struktura të tjera, sidomos, për shembull, e auditimit të fondeve IPA të jashtme, që në përgjithësi specifikimet e punës lihen tek urdhrat apo te nën ligjet. Ligji nuk para përcakton në mënyrë shumë specifike pjesën e kriterëve të rekrutimit, është më shumë një çështje ndarjeje. Çfarë thotë ligji dhe çfarë nën ligji.

Vasilika Hysi – Për drejtorin e Njesisë?

Erion Luçi – Po, për drejtorin e Njesisë.

Shumica e ligjeve nuk shkon në këtë detaj të këtij lloji, të paktën që të specifikojë, sepse ne sapo ndryshuam një specifikim tjetër për një auditor të jashtëm të fondeve IPA, dhe është e mjaftueshme të themi pjesa me urdhër.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, ka gjë tjetër për të?

Gjithsesi, këtu një rekomandim për komisionin përgjegjës, për të përcaktuar kritere specifike për rastet kur janë jashtë kritereve të përgjithshme që ka ligji për shërbimin civil. Pra, kritere specifike, deri sa është njësi specifike e specializuar, që të mos ketë mundësi nesër të abuzohet thjesht mbi rregullat e përgjithshme të rekrutimit.

Dakord. Iva në rregull, Klodi? Në rregull.

Miratohet neni 12, me këtë sugjerim.

Neni 13 “Funksionet e njesisë përgjegjëse për inspektimin financiar”. Nuk kemi gjë. Në rregull.

Neni 14, ka një shënim këtu te legjislacioni në fjalën ligjore dhe në piken 3 germa “c”, fjala “azhurnohen” gjithmonë zëvendësohet me fjalën “informohet vazhdimisht”. Në rregull.

Ministria, në rregull?

Erion Luçi – Formulimi te pika 1 e nenit 14 është sipas përkufizimit që ka bërë Olafi për AFCOS-in dhe është marrë *mot a mot* ai përkufizim.

Fatmir Xhafaj – Po është përkthyer keq tani, pse insistoni.

Jo detyrimet legjislative, po detyrimet ligjore.

Këtu dhe këtë që dimë të bëjmë ne doni të na e hiqni ,mirë atë që dinë ata të Ekonomisë.

Neni 14, miratohet me ndryshimin.

Neni 15.

Dakord, siç është.

Neni 16.

Dakord.

Po, zoti Fino, më falni.

Bashkim Fino - Dua një sqarim këtu bëhet fjalë që inspektorët financiarë publikë kanë këto të drejta.

E drejta e parë është hyrja e pakufizuar në mjediset e njesisë, që është subjekt i inspektimit.

E dyta, qasje e pakufizuar lidhur me inspektimin mbi gjithë informacionin, e kam fjalën, po për informacionin e klasifikuar a duhet? Nuk mund të japësh t’i komplet këtë mundësi. Ju thoni: “Qasje mbi gjithë informacionin”. Po informacionin tek e klasifikuar inspektori juaj futet? Nuk ka të drejtë, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Po e ka ky, sipas nivelit të tyre në përputhje të aksesit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkim Fino - Në rregull, po se e theksoj ndihmoj dhe këta dhe ndihmojmë dhe veten tonë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Oerd Bylykbashi – Besoj se ajo që e ngacmon zoti Fino, mbetet për t’u diskutuar. Në mos gaboj një debat të tillë e kemi pasur edhe me KLSH-në, e cila kërkonte akses të plotë, të pakufizuar te subjektet që do të kontrollonte. Ka pasur dhe një debat shumë të fortë në lidhje me kërkesën për të ndërhyrë, edhe te subjekte private, individë apo persona juridikë, tek të cilët mund të hyhej dhe të bëhejnjë kontroll. Nëse atëherë, në mos gaboj ishte një qëndrim refraktar, për t’i dhënë këtë lloj aksesit, unë besoj se, nëse ne japim hyrje të pakufizuar në mjediset e njësisë, që është subjekt i inspektimit, dhe qasje të pakufizuar në lidhje me informacionet e tjera, pa pasur rregulla të qarta se për çfarë bëhet fjalë – edhe kjo sipas nivelit të tyre të aksesit është e padefinuar – ne mund të gjendemi përballë shkeljes abuzive, që bëhen...

(Diskutim pa mikrofon)

Po meqë po diskutojmë për ta bërë më mirë, a mundet neve të bëjmë kujdes. Sepse mundet që këto institucione, nga institucione inspektimi dhe kontrolli, të kthehen në institucione gjobëvënës, për t’i shtuar edhe një tatimor tjetër atij atje poshtë. Kështu që, a ka mundësi të jemi më të qartë e më të saktë këtu.

Fatmir Xhafaj – Çfarë ka sjellë në praktikë? Ka sjellë gjë dëme në praktikë?

Oerd Bylykbashi – Po sepse deri më sot nuk ka ndodhur kjo. Ne po i hapim mundësinë një njësie, e cila është e kufizuar në burime njerëzore, për të bërë kontrolle në një numër relativisht të madh subjektësh fizike ose juridike, private, të të cilët përfitojnë fonde nga shteti, dhe për shkak të numrit të kufizuar që kanë, do të jenë në mënyrë default selektivë. Selektiviteti mund të jetë me pasoja pastaj, mund të jetë me pasoja abuzimi dhe korrupsioni. Unë po kërkoj rregulla të forta, të qarta, transparente për ata individë, të cilët janë subjekt i këtij ligji, mund ta vuajnë nesër këtë ligj.

Fatmir Xhafaj – Qartë! Në rregull!

Bëni një formulim që mund ta ndihmojë komisionin përgjegjës që të reflektojë, nëse do ta çmojë të arsyeshme.

Eduard Halimi – Këtu ka tre probleme, te neni 16. E para një herë, hyrje e pakufizuar në mjediset e njësisë, që është subjekt inspektimi. Marrim një subjekt privat, futet një institucion publik që të ketë akses pa asnjë lloj paralajmërimi, pa asnjë lloj procedure, që të respektojë të drejtat e tyre, kjo është tërësisht abuzive.

Kërkim të dokumenteve origjinale, të deklarimit të të gjitha llogarive bankare si në vend dhe jashtë tij dhe të çdo dokumenti që ka lidhje me objektin e inspektimit financiar me afate të pacaktuara.

Në qoftë se ai është subjekt privat dhe ka përfutur vetëm për atë pjesë, për atë zë, duhet të përcaktohet qartë. Nuk mund të futet agjencia në të gjithë kompani apo në një subjekt privat, dhe të bëjë batërdinë atje pa pasur e pa respektuar standardet minimale të të drejtave të tyre. Apo edhe parandalim të hyrjes së individëve përgjegjës te kasafortat, magazinat e artikuj të tjerë, subjekt i inspektimit, duke vulosur e duke sekuestruar gjithçka. Çfarë është kjo? Është një kompani që mund të ketë fituar, kot po them, 100 euro, 1000 euro po them nga shteti, dhe ju futeni, ndërkohë që ajo mund të ketë një veprimtari milionash. Kot po them, po marr një rast. Marrim një rast, nga i cili duhet të dalin shembujt përgjegjës. Ndaj e gjitha kjo këtu është tërësisht evazive dhe që lë shumë vend për të qenë...

Fatmir Xhafaj – Ka qenë kështu kjo më përpara?

Eduard Halimi – Mund të ketë qenë. Edhe mund të mos kenë ndodhur probleme, sepse mund të ketë pasur njerëz të përgjegjshëm.

Fatmir Xhafaj – Po kur e hartuar në 2010-ën keni qenë aty.

Eduard Halimi – Po ndoshta atëherë opozita ka qenë symbyllur, ndërsa sot është syhapur. Çfarë të them unë?

Fatmir Xhafaj – Juve i mbyllët sytë kur ishit në pushtet, që t'i kontrollonit, e do t'i hapni sytë tani.

Eduard Halimi – Ka qenë symbyllur atëherë, ndërsa sot është syhapur. Është me katër palë. Çfarë të them unë tani?

Fatmir Xhafaj – Po çfarë do të rregullohet? Pse do të rregullohet?

Eduard Halimi – Tani, kjo këtu është abuzive dhe duhet ndryshuar në mënyrë të padiskutueshme. Absolutisht, kontrolloje, por kontrolloje sipas procedurave.

Fatmir Xhafaj – Mirë. kalojani si sugjerim komisionit përgjegjës. Dakord që t'i sugjerohen vërejtjet.

Neni 17: “Detyrimet e inspektorëve financiarë publikë.”

Neni 18: “Konflikti i interesit publik”.

Neni 19: “Të drejtat e subjekteve të inspektuara”.

Po. dakord me sugjerimin e shkruar në...

Bashkim Fino – Shikojeni një çikë mundësinë e ankimit. Në pikën 2, neni 19, thua: “Kur pjesëmarrja gjatë kryerjes së inspektimit...”

Fatmir Xhafaj – Dakord, për të drejtën e ankimit.

Bashkim Fino – të pengoj unë në kryerjen e inspektimit, ti me një procesverbal më heq nga inspektimi, por s’kam të drejtë të ankimohem unë, sepse mua më kontrollon apo jo?

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimin e bërë nga relatori.

Neni 20, detyrimet e subjektit...

Ilir Meçe – Më fal; domethënë, ideja te pika 2 e nenit 19 është: “Personi i cili është subjekt inspektimi”. Është një lloj si te ligji i inspektoratit, do të thotë: gjatë punës që inspektori kryen në subjekt, kur një nga punonjësit e subjektit i krijon probleme, ai e largon. Kjo nuk i heq të drejtën personit nga bërja e observacionit, por nuk merr pjesë gjatë procesit të inspektimit, sepse mund të jetë arrogant, mund të jetë represiv. Ai duhet të dalë nga ambienti ku kryhet inspektimi, por nuk i hiqet e drejta e bërjes së observacionit.

(Diskutim pa mikrofon)

Të ankimojë, që të dalë nga zyra.

Bashkim Fino – ...gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni, pengon kryerjen e veprimtarisë së inspektoratit, inspektori, pra ti, me një fjalë, mund të vendosësh përjashtimin tim nga pjesëmarrja, se të pengoj unë ty. Pikë. Vendimi pasqyrohet në procesverbal, që më ke përjashtuar mua.

Ilir Meçe – Që të jetë prezent. Bëhet fjalë vetëm për prezencë.

(Diskutim pa mikrofon)

Ideja është se unë tri ditë i kam aty. Po u nisa me këtë, më shkon inspektimi gjashtë muaj.

(Diskutim pa mikrofon)

Nuk ta heq të drejtën e animimit.

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Unë them që këtë propozim që kemi bërë neve, ta shikojë komisioni përgjegjës.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë sugjerim, për ta vlerësuar ata.

Neni 20.

Eduard Halimi – Te neni 20 unë kam një pyetje. Çfarë ndodh nëse subjekti i inspektimit nuk bashkëpunon me inspektorët financiarë, nuk ua dorëzon materialet, nuk respekton? Çfarë ndodh? Kemi plot raste ne. Bën KLSH-ja rekomandime, nuk ndodh asnjë gjë. Vjen në parlament, nuk ndodh asnjë gjë. Çfarë ndodh? Çfarë do të bëjmë? Do të bëjmë përsëri një ligj, që do ta kemi përsëri blanchet? Çfarë ndodh?

Pashë nenin 20, pashë dhe dispozitat, se mos kishte ndonjë gjë të shkeljet administrative apo te dispozitat kalimtare të fundit, por s'ka asnjë gjë. Çfarë ndodh?

Ilir Meçe – Për sa i përket nenit 20, në qoftë se subjekti nuk hep informacion, pra bllokun inspektimin, kam përshtypjen se Kodi Penal ka një nen për bashkëpunimin me strukturat, dhe bëhet kallëzim penal për pengim të punës.

(Diskutim pa mikrofon)

Po unë do të bëj një kallëzim penal. Kaq. Nuk mund të bëj më shumë. Ndërkohë, për sa i përket zbatimit të urdhrat të ministrit...

(Diskutim pa mikrofon)

Po e ka Kodi Penal.

(Diskutim pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Mund të jetë si kërcënim.

Fatmir Xhafaj – Ky, kërcënim s'është fare. vetëm kërcënim s'ka këtu, por...

(Diskutim pa mikrofon)

Ju lutem, me mikrofon.

Eduard Halimi – Pra, sugjerimi është: në qoftë se ka veprime të cilat përbëjnë vepër penale për subjektin privat, shtetëror e me radhë, por edhe fizik apo shtetëror publik, të bëhet – të mos lihet e bardhë dispozita – jo blanchet por të bëhet dispozitë referuese. Gjejeni dispozitën përkatëse në Kodin Penal, riformuloheni, silleni këtu, dhe parashikoni se mospërbushja e nenit 20 në dispozitat ku e keni, te kreu i katërt, pra mospërbushja e kësaj përbën këtë vepër penale. Gjejeni ku e keni, se unë nuk e di që të këtë. Nuk di të këtë një gjë të tillë. Pra, në qoftë se unë s'të

kthej përgjigje ty, është shkelje administrative në qoftë se jam në shtet, por nuk përbën vepër penale. Megjithatë, në qoftë se ju jeni të bindur se e gjeni, gjejeni, na e sillni dhe ta bëjmë prapë.

Fatmir Xhafaj – Pse s’i vendosni me një sistem gjobash këto?

Ilir Meçe – Jo, bëhet fjalë kur ata nuk pranojnë inspektimin. Nuk bëhet fjalë kur nuk kthejnë përgjigje.

(Diskutim pa mikrofon)

Eduard Halimi – Çdo subjekt është i detyruar të bashkëpunojë e të mos i pengojë inspektorët, t’u ofrojë inspektorëve të drejtën e përdorimit të pakufizuar të mjediseve. S’ta ofrojnë. Sepse, ta tregova rastin e mëparshëm: jam subjekt privat. Ju vini të bllokoni kasafortat, ndërsa unë them se duhet të kontrolloni vetëm këtë. Të drejtën e ankimit, sipas asaj që thotë Bashkimi, ju ia keni hequr.

Fatmir Xhafaj – Jo, se s’është ashtu.

Eduard Halimi – Do të bëjmë procesverbalin dhe ta bëjmë bashkë. Unë them: nuk jua jap! Sepse duhet të ma përkufizoni kontrollin vetëm aty ku unë kam përfituar para nga fondet publike apo shtetërore.

Në këtë pikë ngelemi përsëri në qorrsoak, ngelemi të bllokuar, ndërkohë që unë nuk kam asnjë detyrim për t’ua bërë një gjë të tillë. Çfarë ndodh mbrapa? Se këtë nuk e gjej. Të zbatojë masat e kërkuara nga ministri i Financave, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”. Nuk e bëj. Sepse ne kemi ligjin e KLSH-së. Aty ka edhe sanksione dhe nuk zbatohen. Atëherë çfarë po bëjmë me këtë. të njëjtën gjë? Të nxjerrim mësim nga problemet që kemi pasur.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ilir Meçe – Për sa i përket pjesës së parë, neni 4 i ligjit, në germën “c” ka parashikuar për çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga buxheti i shtetit, Bashkimi European ose marrëveshjet. Pra, kur shkohet në një subjekt privat, ligji e ka parashikuar se për çfarë shkon. Pra, nuk mund të shkoj e t’i kontrolloj gjithë aktivitetin subjektit, por vetëm për fondet në lidhje me të cilat ka ardhur parregullsia. Pra, kjo është e kufizuar, nuk është se s’është e kufizuar.

Fatmir Xhafaj – Mirë, pra mirë. Shqetësimi është që, në rastet kur veprimtaria inspektuese ndesh në reagime joligjore të subjekteve të inspektuara, çfarë do të bëhet? Kaq. Këtu duhen disa masa, që të...

Po. ka tjetër për nenin 20?

Dakord!

Neni 21: “Përmbushja e inspektimit”. Nuk ka.

Neni 22: “Informimi i autoriteteve”.

Bashkim Fino – Kam unë një gjë të vogël.

...përmend te pika 3: “Informohet edhe ministri i Financave, edhe KLSH-ja”. Se, ju thoni: informacioni pas rezultatit, sipas këtij neni i dërgohet autoritetit më të lartë që ushtron të drejtën e punës shtetërore ose vendore të kapitalit të njësisë ose individëve që inspektohen. A do t’i raportohet ministrit të Financave dhe KLSH-së për këtë gjë?

(Diskutim pa mikrofon)

Ilir Meçe – Çdo inspektim ka firmën e ministrit të Financave.

Bashkim Fino – Dakord, dakord. Mbasi mbaron puna, flas. Mbasi është bërë kontrolli, ai dërgohet ministrit të Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit? Për këtë pyeta.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Te Kontrollit të Lartë të Shtetit, sepse kuptohet rasti i ministrit, a ka nevojë të dërgohet apo s’ka nevojë? Pra, ti dërgohet për dijeni, që ai të...

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, ai s’ka lidhje fare. Ky është inspektim i brendshëm. Kontrolli i Lartë të Shtetit ka punën e vet, ky ka punën e vet. Thjesht të mos vendoset kontroll mbi kontroll, të mos ketë dublim, ndoshta. Ky është shqetësimi. Duhet ta informojë ministrin e Financave. Besoj se e informon ai. E njëjta gjë duhet bërë, që të mos ketë mbivendosje. Ose, kur shkon inspektimi, ta dijë se aty ka pasur Kontrollin e Lartë të Shtetit, që edhe ai ta dijë se aty ka qenë inspektimi dhe ka nxjerrë këto probleme. I ndihmon reciprokisht organet kontrolluese. Unë bëj pjesë tek ata që besojnë se sa më shumë kontrolle e sa më të forta të jenë, aq më mirë është. Problemi, shqetësimi që kemi, siç e kuptoj unë, është te fakti që këto të mos jenë abuzuese ose selektive. Problemi që ne kemi sot, është se nuk kemi kontrolle të forta. Të gjitha këto që bëhen, sipas pikëpamjes sime, janë më shumë zhurma se sa realitete. S’duhet të jenë selektive dhe abuzive, dhe që të jenë të harmonizuara. Kjo është. S’kemi arsye të mos e respektojmë dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit në punën e vet, edhe këtë inspektimin në punën e vet.

Po, zoti zëvendësministër.

Erion Luçi – Domethënë, inspektimi firmoset nga ministri i Financave.

Fatmir Xhafaj – Qartë.

Erion Luçi – Ndërkohë, edhe KLSH-ja, gjëja e parë që bën kur vjen për auditivet e radhës, është pikërisht konsultimi i raporteve që janë publike...

Fatmir Xhafaj – Mund ta vendosni, ndoshta, në qoftë se e çmoni, në qoftë se nuk ju prish punë. Edhe ata ta kenë këtë detyrim, them unë. Struktura të shtetit janë, pavarësisht se mund të jenë të ndara.

Erion Luçi – Në një pikë të caktuar, kjo si njësi nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit me shumë aktorë, përfshi edhe KLSH-në, edhe prokurorinë. Te memorandumi shkëmbimi i informacionit është një nga gjërat bazë, domethënë, sepse e kemi edhe detyrim ndaj fondeve të (...). Mund ta vendosim edhe këtu, por mund të ketë njëfarë publikimi.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Shikojeni edhe këtë. Dakord.

Neni 23.

(Diskutim pa mikrofon)

Po?

Bashkim Fino – Informacioni për rezultatin e inspektimit financiar, sipas pikës 2 të nenit 4. Nuk ka pikë 2, neni 4 i këtij ligji. Ka vetëm germa “a”, “b”, “c”. Duhet rregulluar. Informacioni për rezultatet e inspektimit financiar, sipas pikës 2, të nenit 4. E ke: neni 4, me gerrat “a”, “b”, “c”.

Fatmir Xhafaj – Ka qenë në draft, por nuk e kanë korrigjuar.

Bashkim Fino – Po hë pra, rregullojeni!

Fatmir Xhafaj – Korrigjohet te versioni final.

Bashkim Fino – Duhet ta korrigjoni, s enuk shkon kjo pika 2 këtu. Se kam një orë që po e kërkoj e s’po e gjej dot.

(Diskutim pa mikrofon)

Epo, ç’rëndësi ka, gjejeni e vëreni. Thuajeni tani si duhet vënë pika “b”, pika “c”.

(Diskutim pa mikrofon)

Te neni 4 ke “a”- njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Pikën “b”- shoqëritë shtetërore, pikën “c”- çdo person fizik.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Dakord. U kuptua kjo.

Bashkim Fino – Si u kuptua?

Fatmir Xhafaj – Që do të korrigjohet kjo. Derisa s’ka pikë 2. Si tha ai? Pse nuk bien kambanat? S’ka kambanë. Epo, nëntëdhjetë e nëntë të tjerat lëri! Duhet hequr.

Iku 22-shi, me sugjerimet që bëri zoti Fino. Ah, po, më fal.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Atëherë, po te ky nen: “Informimi i autoriteteve”. Unë besoj se është një nen i cili është në gjysmë të rrugës për të dhënë një lloj transparence për atë që është bërë. Një pjesë është detyrim i brendshëm, por ajo që diskutuam është nëse KLSH-ja duhet të ketë informacion.

Fatmir Xhafaj – Po e tha, pra.

Oerd Bylykbashi – Më fal, unë do të shkoja më tej: do të sugjeroja që ligji të parashikojë se këtë informacion konkluzionet e inspektimit të bëhen publike, në mënyrë që kushdo që ka interes, të ketë akses te ky informacion, se cilat janë konkluzionet. Pra, nuk është thjesht një histori e brendshme. Ky është një interes publik, prandaj po bëjmë një inspektim të brendshëm, sepse po duam të shohim se si përdoren paratë. Kështu që, unë sugjeroj që ne të kemi një dispozitë, e cila rregullon dhe detyron publikimin e konkluzioneve të kontrollit të brendshëm.

(Diskutim pa mikrofon)

Secili institucion...

(Diskutim pa mikrofon)

Edhe një herë: unë po flas për konkluzione, të cilat mund të bëhen publike, sepse, me atë që thoni juve, po shkojmë të marrim përjashtimin për ta bërë rregull.

(Diskutim pa mikrofon)

Ajo që unë po them është: unë nuk e di nëse përveçse për arsye të sigurisë kombëtare të përdorimit të fondeve publike, shumica dërmuese e institucioneve të këtij shteti përdor para për interes publik, jo sekret, dhe konkluzionet e përdorimit të këtyre parave duhet të bëhen publike. Vërtetë është kontroll i brendshëm, por kjo nuk do të thotë: meqë u bë, e varrosim aty dhe askush nuk di asgjë. Vetëm nëse shkon KLSH-ja. Edhe kur shkon, nëse e sheh.

Kështu, unë gjykoj se do të ishte mirë të kemi një dispozitë, e cila detyron çdo institucion që ta bëjë publik këtë informacion.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti zëvendësministër.

Erion Luçi – Kjo është dispozitë e parashikuar te aktet nënligjore, por në qoftë se mendojmë ta ngremë në nivel ligji, domethënë...

Fatmir Xhafaj – Po e japim edhe këtë si sugjerim te komisioni përgjegjës. Në rregull.

Neni 23: “Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit”.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, po. dakord me sugjerimin e bërë?

Dakord.

Neni 24: “Shkeljet penale”.

Në rregull, dakord.

Neni 25: “Masat disiplinore”. Dakord?

(Diskutim pa mikrofon)

Po.

Vasilika Hysi – Te neni 25, ju thoni se për inspektorin financiar publik, që është punonjës i administratës publike, ka masa disiplinore. Në fakt, ky nen bie ndesh me nenin 7, pikën 2, ku ju thoni se veprimtaria e inspektimit mund të kryhet nga punonjës të njësisë, por në rast se nuk ka punonjës të mjaftueshëm, ka mungesë të burimeve njerëzore, mund të merren edhe ekspertë të jashtëm. Ky eksperti i jashtëm, a do të mbajë ndonjëherë përgjegjësi, sepse e keni nxjerrë pa përgjegjësi fare? ndërkohë, në ligjin ekzistues ka qenë më mirë e rregulluar përgjegjësia e inspektorit financiar publik, që është pjesë e administratës publike, edhe ku ai vjen si një ekspert i jashtëm.

Prandaj, do të sugjeroja që të kishte përgjegjësi sipas kodit të procedurave administrative: është në kundërvajtje, të ketë një gjobë apo çfarë do të ketë, sepse ju ndëshkoni vetëm punonjësin e administratës publike, dhe jo ata që mund të jenë ekspertë të jashtëm. Ose, nëse ka ndonjë rregull për këta që janë ekspertë të jashtëm, duhet ta referoni. Në rastin kur inspektimi është bërë nga punonjës ekspertë të jashtëm, atëherë përgjegjësia rregullohet në bazë të ligjit përkatës, si është, sepse, kështu i keni lënë zbuluar.

Erion Luçi – Në fakt, përfshirja e ekspertëve të jashtëm është punë specifike, që nuk mund të mbulohet, le të themi, nga njësia inxhinierike....

Fatmir Xhafaj – Dakord. Për efekt të tyre ka ardhur një pasojë, që është...

Erion Luçi – E qartë. Ideja është se, kur merret një ekspert i jashtëm, ka një kontratë dhe ka një detyrim financiar shumë të qartë në nënshkrimin e kontratës. Për shembull, ekspertët e jashtëm që firmos unë, të paktën, nuk marrin shpërblimin ose fondet, nëse unë nuk jam i kënaqur me punën e tyre. kështu që, në një aspekt të caktuar marrëdhënia mes tyre rregullohet nëpërmjet një kontrate të mirëspecifikuar. Tani, ne mund të vendosim përgjegjësinë këtu, domethënë, por

kontrata është shumë e detajuar në këtë aspekt. Për shembull, çfarë i kërkohet atij, që të dorëzojë raportin në fund të muajit, në bazë të çfarë kriteresh? Ne kërkojmë vlerësimin e punës së tij e të tjera.

Tani, nëse do, mund të vendosim një ekstra këtu, por prapë, këto kontrata, me ekspertët e jashtëm që ne kemi aktualisht, janë goxha më komplekse, le të themi, në këtë pikë. N mund të marrim një kontrate tip e ta zbatojmë edhe në këto raste, siç dhe do të bëjmë. Kjo ide është më shumë për të rritur efektivitetin dhe është një nga pikat kryesore të ndryshimit të ligjit, sepse deri më sot inspektorët zgjidhen në mënyrë rastësore dhe në përgjithësi i shmangen detyrës, se sa e ndjekin detyrën. Kjo krijon edhe një obligim ekstra, një obligim shtesë, që ata ta bëjnë punën ashtu siç duhet.

(Diskutim pa mikrofon)

Për këta të administratës publike?

Vasilika Hysi – Për këta ekspertët që nuk e bëjnë punën.

Erion Luçi – Jo, jo, ekspertët akoma nuk janë mobilizuar.

Fatmir Xhafaj – U ndërpritet kontrata.

(Diskutim pa mikrofon)

Erion Luçi – Më fal, jam unë pastaj, që jam subjekti mi jorregullsisë, sepse më vjen mua një audit dhe e shikon që kam firmosur një punë për inspektim, që nuk ka dhënë rezultate.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. dakord.

Neni 26: “Ankimimi...”

Erion Luçi – Domethënë, është edhe pika 5 e nenit 9, për shembull, ku ministri i Financave ka edhe të drejtën të vërë në listën e zezë ekspert të jashtëm.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po e ke përgjegjësi pra, e heq nga lista. E heq nga lista.

Këta s’bëjnë inspektime, pa sikur të bënin inspektime, le të bëjnë gabime; ku ma gjen.

Neni 26: “Ankimi në rrugë gjyqësore”. Dakord?

Neni 27: “Periudha transitorë për zbatimin e ligjit”. Dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Nëntë muaj. Mirë e ka Bashkimi.

Bashkim Fino – Këta e kanë ligjin në fuqi, atë të 2010-ës. Këta duan ta bëjnë më efektiv.

Fatmir Xhafaj – Brenda tre muajve...

Bashkim Fino – Po pra, më kupton?

Fatmir Xhafaj – Neni 28: “Shfuqizimet, dakord.”

Neni 29: “Hyrja në fuqi”. Dakord?

Dakord në tërësi me vërejtjet e sugjerimet e bëra?

Faleminderit!

Ju lutëm, raportin. Këshilltarët të jenë të kujdesshëm me vërejtjet e sugjerimet që u bënë këtu, e me çfarë ne kemi propozuar drejtpërdrejt, dhe çfarë kemi sugjeruar që janë objekte rishikimi nga ana e komisionit përgjegjës.

Në rregull! Vazhdojmë me projektligjin tjetër, projektligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,

Paraqitja u bë nga zëvendësministri. Ka pyetje? Nuk ka pyetje. Diskutime? Nuk ka diskutime.

Po.

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me diçka që u tha më parë këtu për retorikë politike, s’epo përmirësojmë ligjet tuaja, në fakt këto të dy janë ligje që kanë nisur herët, që në vitin 2012, me një projekt e me asistencën e SIGMA-s, në mos gaboj, për t’u përmirësuar legjislacioni ekzistues. Pjesa dërrmuese e punës kishte mbaruar, po përfundon, janë ligje që kanë nevojën e tyre.

Fatmir Xhafaj – Po.

Oerd Bylykbashi – Është e vërtetë ajo që tha kolegu Ristani pak më parë, që nuk mundet neve, që vullnetin negativ në zbatimin e ligjit e, po themi, të financave publike, dëshirën e individëve për të përfituar nga fondet publike dhe për t’u pasuruar në mënyrë marramendëse, ta kufizosh gjithmonë me ligj. Megjithatë, ne do të bëjmë detyrën tonë. Por, në çdo rast mbetet për t’u parë se sa, ky vullnet që do të vijë nga institucionet qendrore që zbatojnë këto, do të na garantojnë neve, ndër të tjera, përveç asaj që u përmend më herët sot, abuzimin me pushtetin shtetëror, për faktin e unë marr dikë në punë dhe pastaj e detyroj të paguajë kuotizacionin nëpërmjet kanaleve shtetërore, në shkelje skandaloze e flagrante të ligjit. Jo vetëm të ligjeve standarde për menaxhimin e financave, por edhe të ligjit për financimin e partive politike. ne jemi gjithmonë e më shumë përpara abuzimesh të papara më parë me fonde publike, për sa u përket tenderëve, për sa i përket prokurimit publik. Gjithmonë e më shumë po shohim se rregulli nuk është prokurimi i hapur, por prokurimi i hapur po bëhet përjashtim, ndërkohë që prokurimi i drejtpërdrejt, siç e njohin shqiptarët, po bëhet rregull.

Gjithmonë e më shumë po shohim se si fondet po përfitohen nga kompani, të cilat fitojnë me fond maksimal, të cilat e përfitojnë tenderin me fondin limit. Sigurisht, nuk janë procedura të cilat i zgjidh këtui, ky ligj, për sa u përket procedurave të kontrollit dhe të ankimimit, por në fund fare këto instrumente na ndihmojnë për të parë se si po shkon, dhe eventualisht, për të parandaluar abuzimet. Por, ajo që është më e keqja gjithmonë, është se ligji nuk e pengon vullnetin e keq. Ne gjithmonë e më shumë po shohim përjashtime nga detyrimi për prokurim publik standard, me transparencë, në mënyrë të hapur. Për shembull, në një ligj, në mos gaboj në ligjin “Për turizmin” parashikohet...

Fatmir Xhafaj – Tashti, të fokusohemi te ky për auditimin e brendshëm, dreqi e mori...

Oerd Bylykbashi – Pikërisht pra, për paratë e shqiptarëve po flasim.

Fatmir Xhafaj – Po hajt ta bëjmë ligjin mirë, që të mos flasim kot tashti.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, të mbaroj dhe pastaj... Ky është opinionimi im. Se çfarë them unë...

Fatmir Xhafaj – Mund të flasësh, në daç, edhe për ndeshjen Shqipëri-Portugali.

Oerd Bylykbashi – Ky ligji këtu, brilant të jetë, në qoftë se Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka vendosur që këto fonde të tenderohen në mënyrë të drejtpërdrejt, nuk e ndalon dot. Nuk ka asnjë zyrtar që ia mban dorën atij.

Fatmir Xhafaj – Ti bëj debat me Kryeministrin në seancë, jo këtu.

Oerd Bylykbashi – Jo vetëm aq, por edhe atë do ta bëj.

Fatmir Xhafaj – Bëje!

Oerd Bylykbashi – Jo vetëm aq, por me ligj po miratohet, që fondet publike të mos i nënshtrohen ligjit “Për prokurim publik”, siç është rasti i publiciteteve për turizmin. Me ligj specifik përjashtohet, dhe nuk e di se çfarë do të kontrollojnë më pas këta zotërinjtë, me këto instrumente.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Oerd Bylykbashi – Sepse nuk ka asnjë procedurë ligjore të ligjit “Për prokurim publik”, që do të zbatohet. Kështu që, ne po përpiqemi të bëjmë instrumente s amë të mirë kontrolli dhe auditim, por jemi përpara një vullneti që, parandë publike po e abuzon në mënyrë skandaloze.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Bashkim Fino – Nuk dua të bëj politikë, por, e thashë edhe një herë: ligji i 2010-ës ka pasur një komitet auditivi të Ministrisë së Financave, apo jo, që bënte metodologjinë e njërën a

tjetrën. Ky ligj, çfarë po sjell sot? Krijon komitete auditivi pranë çdo njësie të qeverisjes publike, që do të thotë se e kanë për detyrë të bëjnë kontrole të brendshme të vazhdueshme për fondet buxhetore. Pra, shtojnë instrumente për të kontrolluar paratë e shqiptarëve. I shtojnë këto instrumente pikërisht për të bërë këtë kontroll, pa llogaritur fare inspektimin që përmendëm përpara, pa llogaritur KLSH-në, që janë institucione të tjera, e të tjera me radhë.

Në qoftë se duhet ta kalojmë me të dyja duart dhe ta miratojmë, ky është ligji. Unë nuk e kuptoj përse bëjmë diskutime politike për një ligj që është specifik, teknik dhe thjesht na paraqet këtë gjë, që krijojmë auditime të brendshme në të gjitha njësitë publike. Kishim një komitet, krijojmë disa komitete dhe kaq, vazhdon puna më poshtë. Pra, forcojmë kontrollin e brendshëm, që deri dje nuk ka qenë. A është ka ardhur në këtë parlament KLSHH-ja dhe është ankuar se s'ka mundësi t'i kontrollojë të gjitha njësitë? Kur qenë 383 njësi vendore, po marr njësitë vendore si shembull, ndërsa sot janë 6 dhe kanë vite e vite të tëra pa u kontrolluar. Ndërkohë, ne me këtë ligj themi: jo, ne do ta krijojmë vetë këtë kontroll të brendshëm. Do ta kontrollojmë vetë, për të ecur përpara e për të menaxhuar fondet e shqiptarëve.

Tani, në qoftë se ne vëmë rregulla, vëmë instrumente e ët tjera e të tjera, në vend që të an falënderoni që s'i keni vënë në tetë vjet, vini e na thoni: mirë, vëri, por keni njerëz të përgjegjshëm për t'i zbatuar. Po t'i vëmë një herë. Ne jemi legjislacioni. Do t'i kontrollojmë nesër se si kemi kontrolluar. Kaq kisha.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka gjëra të tjera? S'ka.

Kush është dakord në parim?

Kundër? Ka kundër? S'ka kundër.

Abstenime? S'ka abstenime.

Miratohet në parim!

Vazhdojmë me nen për nen.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, po. Dakord.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Neni 3: “Fusha e zbatimit të ligjit”. Dakord.

(Diskutim pa mikrofon)

Në rregull. dakord me vërejtjen e zotit Fino për renditjen e përkufizimeve.

Neni 5: “Misioni”.

(Diskutim pa mikrofon)

Eduard Halimi – Te neni 4, “Kontrolli i brendshëm”, termi ka të njëjtin kuptim si në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Domethënë, për këtë duhet të gjej atë ligjin tjetër që të gjej termin këtu?

Fatmir Xhafaj – Po mirë, patjetër. Keni nevojë ta specifikoni këtë?

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Kontrolli i brendshëm ka të njëjtin kuptim si në ligjin “Për menaxhimin financiar”? Vendoseni këtu, që edhe opozita të ndjehet mirë.

Në rregull.

Neni 5: “Misioni”. Dakord me vërejtjet dhe sugjerimet e relatorit? Dakord.

Neni 6: “Roli i auditit të brendshëm”. Dakord.

Neni 7: “Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit të brendshëm”. Dakord.

Neni 8: “Standardet dhe metodologjia e auditimit të brendshëm”. Dakord.

Neni 9: “Llojet e shërbimeve të auditimit të brendshëm”. Dakord.

Neni 10: “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm”. Dakord.

Neni 11: “Punësimi i audituesit të brendshëm”.

Po, ka disa sugjerime këtu te neni 11. Në nenin 11 të shikohet germa “c” dhe “ç” në raport me njëra-tjetrën dhe në raport me statusin e nëpunësit civil.

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Po të shikosh me kujdes, në nenin 11, germa “c” thotë: audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si auditues i brendshëm dhe të ketë përvojë pune pesë vjet në profesion, ndërsa germa “ç” thotë: “Punonjësi që nuk zotëron certifikatën e audituesit të brendshëm, por që ka përvojë deri në 3 vjet”, pra, më pak në profesion “punësohet në njësitë e auditimit të brendshëm dhe gjatë dy viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejt”.

Fatmir Xhafaj – Pra, ju ia jepni me pikën “c” dhe ia merrni me pikën “ç”.

Bashkim Fino – Po. Po.

Fatmir Xhafaj – Ka një konflikt midis këtyre dy germave. Ka ndonjë shpjegim nga ana juaj?

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Cili është ai neni i mëparshëm? Është një nen tjetër që, kur vijmë më pas, merr në konsideratë pikën “ç” dhe jo pikën “c”. Sipas pikës “c” është 5 vjet në punë ai, ndërsa “ç”-ja e ka tre vjet në punë. Duhet ta rregullojmë.

Fatmir Xhafaj – Po. Zoti zëvendësministër.

Erion Luçi – Këtë e kisha edhe unë pak merak, në aspektin e krijimit të fluksit të njerëzve që vijnë brenda dhe që certifikohen në punë. Ideja e kësaj është që të lihet një periudhë kohe për të rinj, që të marrin eksperiencë dhe të kualifikohen për të marrë certifikata, por këta nuk do të kenë të drejtë dhe nuk do të quhen auditues të brendshëm, megjithëse punojnë në audite të brendshme për firmë ose për raporte të caktuara.

Tani ideja është që të ketë njëfarë fluksi për hyrjet e ëpr daljet

Fatmir Xhafaj – S’kemi auditues të brendshëm ne sot në treg?

Erion Luçi – Në treg kemi dhe kemi një çikë ëm shumë se ç’duhet...

Fatmir Xhafaj – Po atëherë përse duhet të marrim një njeri që ta mësojmë aty?

Erion Luçi – Sepse kualiteti i tyre ka rënë goxha, pikërisht me këtë dhënie certifikatash, që është një nga synimet e ligjit të ri, që të rrisë cilësinë duke ulur pak numrin dhe duke kufizuar numrin e certifikatave brenda atyre që bëjnë punën e audituesit të brendshëm. Certifikatat do të kufizohen më shumë se sa, të themi, thjesht ata që janë certifikues, për të krijuar një presion për të rritur cilësinë. Është arritur deri tani.

Një element tjetër i rëndësishëm, që ndoshta s’e përmenda më përpara, është edhe kjo pjesa e trajnimeve të detyruara. Pra, nuk mund të mbash certifikatë nëse nuk merr trajnime në mënyrë konstante, që mund të filtrojë akoma më shumë këtë pjesën e audituesve që më parë kanë marrë certifikata thjesht si letra.

Fatmir Xhafaj – A nuk keni mundësi të bëni një paraseleksionim, një konkurrim, në mënyrë që ta mbani atë me pesë vjet. Pse duhet ta mbani me dy nivele, se duket pak selektive. Unë s’e kuptoj mirë këtë punën e auditimit, me thënë të drejtën. S’jam shumë i familjarizuar.

Erion Luçi – Në përgjithësi zyrat e auditit funksionojnë edhe me auditues jo të certifikuar, sespe duhet t’u lësh mundësinë. Le ët themi, edhe inxhinierëve apo edhe të tjerëve. Për shembull, kur auditon hidrocentralet ke nevojë për njerëz të specializuar.

Fatmir Xhafaj – Qartë, qartë, por e ka parashikuar ligji. Ti merr ekspertë të jashtëm.

Erion Luçi – Ke nevojë edhe për specialistë, edhe për...

Fatmir Xhafaj – Po merr edhe nga profesione të caktuara, merr auditues në ndihmë të auditorëve, por këta janë auditorë financiarë, praktikisht.

Erion Luçi – Jo, këta janë auditorë të brendshëm në shumë njësi, dhe njësi të caktuara kanë specifikimet e tyre të caktuara. Për shembull, qeveritë lokale mund të kenë një specifikë më të ndryshme.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. vetëm shikojeni këtë.

Erion Luçi – Mund ta shikojmë.

Fatmir Xhafaj – Duket pas si selektive. Duhet të kesh pesë vjet, po meqenëse ti ke tre, po të marr dhe po t'i jap unë dy vjet këtu.

Siç e trajtoni ju, qëllimi duket i mirë, por e formuluar kështu, nuk të lë... Mund të ribëni një riformulim, domethënë për gjëra të specializuara, për auditues të specializuar e të tjera e të tjera. të ketë një veçori.

Erion Luçi – Qartë.

Fatmir Xhafaj – Po?

Eduard Halimi – Kam një propozim për një amendament te neni 11, lidhur me punësimin e audituesit të brendshëm. Dua që të shtohet një kriter për të punësuar, që personi të mos ketë rekorde kriminale, pra të mos jetë dënuar parë për krime të rënda dhe të mos jetë dënuar më parë – edhe pse mund të jetë koha e rehabilitimit – për krime financiare, në mënyrë që pastaj të mos ndodhemi para mundësisë për t'i marrë në punë. Unë e di se kjo është çështje e Komisionit të Dekriminalizimit, që ka zoti Bylykbashi pak më vonë, por të mos ndodhemi para situatës kur ky ligj mund të ë hyjë më parë në fuqi e të themi: “Po prit, se tani ky e mori postin”, “Jo, po prit, se kur e mori postin ky, nuk ishte e ndaluar të ishte me rekorde kriminale për t'u bërë drejtor e auditues, ndërsa tani s'kemi çfarë t'i bëjmë sepse e mori postin”.

Prandaj, meqenëse jemi këtu, këtu janë të gjitha ligjet që do të vijnë më pas.

Fatmir Xhafaj – Ky do të dalë pas atij ligjit që do të nxjerre zoti Bylykbashi.

Eduard Halimi – Po s'ka p[roblem. Po doli më përpara, ne pse vendosim pragje dhe jemi të gjithë dakord – se të gjithë dakord jemi – sepse njerëz me rekorde kriminale s'kemi pse i vëmë në audit. Kështu që, derisa biem dakord të gjithë. Le të shtohet kjo.

Fatmir Xhafaj – Po kjo s'mund të jetë në çdo ligj. Është një normë e përgjithshme tani, mos e bëni...

Eduard Halimi – Po kështu është kthyer pra, domethënë. Po vazhdon e po bëhet e përditshme.

Fatmir Xhafaj – Të mos ketë marrë gjoba makine, thotë zoti Majko.

Eduard Halimi – Kemi dy vjet që po dalim e po themi këtë histori, dhe sa herë dalin ditë për ditë njerëz që paskan qenë me rekorde kriminale; prit, se edhe ky paska qenë trafikant: prit, se edhe ky është dëbuar nga Italia, nga Zvicra, nga Belgjika.

Që të mos ndodhemi në situata si këto, ne jemi Komision i Ligjeve, dhe le të vendoset një kriter i tillë për njerëz të cilët kanë rekorde kriminale.

Fatmir Xhafaj – Po.

Erion Luçi – Ky ligj është brenda ligjit të nëpunësit civil ose është i lidhur me ligjin e nëpunësit civil, që në mënyrë specifike përcakton mosmarrjen në punë të individëve që janë në ndjekje, ose janë...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ndërhyrja që do të bëhet te ligji “Për nëpunësin e shërbimit civil” do të efektojë drejtpërsëdrejti.

(Diskutim pa mikrofon)

Dakord.

Erion Luçi – E ka që tani.

Fatmir Xhafaj – Firmoseni atë letrën aty, dhe neni 12...

(Diskutim pa mikrofon)

Po, po.

Neni 13.

Jo, hyri te neni 11 zoti Halimi dhe tha t’i bie gozhdës një çikë, sepse s’i kishte rënë për sot.

Neni 13. Dakord?

Meqenëse jemi te auditivi, u kujtua.

Neni 14.

(Diskutim pa mikrofon)

Po pra. Atë do ta rishikojmë bashkë. Ramë dakord me zëvendësministrin, që ta rishikojmë bashkë me këshilltarët.

Te neni 14, germet “d” “dh” “e”, “f”, të hiqen.

(Diskutim pa mikrofon)

Te neni 14, kemi gjë? Germat “d” dhe “f” të hiqen. Po pse duhet të hiqen këto? Po, dakord.

Neni 14.

Në rregull: Shkronja “f” të riformulohet në përputhje me nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, si më poshtë. Dakord?

(Diskutim pa mikrofon)

Po, po. Germat “f” dhe “e”, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Bëjeni riformulimin që përpara, ju këshilltarët! Klodi, bëjeni riformulimin dhe jepeni këtu me formulim.

Dakord me 14 “Të drejtat e audituesve të brendshëm”? Dakord.

Neni 16. Dakord.

Neni 17.

(Diskutim pa mikrofon)

“Pas publikimit, shtohen fjalët sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin e nëpunësit civil”.

Po, ky është një rregullim.

Zoti Halimi, po.

Eduard Halimi – Tani, këtu në pikën “b” thuhet: “Ndalohej të mbajnë një mandat politik apo të jenë të zgjedhur në funksionet drejtuese të strukturave partiake politike”.

Unë them se përsëri kjo është lart shumë. Audituesve të brendshëm u ndalohej të jenë edhe pjesë e strukturave politike. Vetëm të jenë drejtues të lartë. Është bërë vetë “të jenë drejtues të strukturave politike”, jo drejtues... Se çfarë na ndodh tani? Çfarë po dëgjojmë ne tani? Duhet të jenë drejtues të strukturave. Tani, drejtues ne kemi komisarët për Jugun, komisarët për Veriun. Këta komisarë tani, që ju i keni ndarë sipas rajoneve, kanë shpërndarë dhe kanë bërë listat se kush është me PD-në, kush ka qenë me PS-në e kush ka qenë me LSI-në në zgjedhje; tani bëni lista për të hequr nga puna nga i pari deri te i fundit.

Fatmir Xhafaj – Po çfarë lidhje ka kjo? Bëj një propozim.

Eduard Halimi – Prit të mbaroj, pra. Këtu është kthyer në një sistem të tillë që, po të mos jesh në një forcë politike nuk futesh dot në punë në shtet. Nuk ka këtu as konkurs e asgjë.

Fatmir Xhafaj – Po atëherë si t’ia bëjmë? Atëherë ta shënojmë se duhet të jesh anëtar partie politike?

Eduard Halimi – Formulimi im është jo të jetë vetëm lart, jo të jetë vetëm drejtues, se drejtuesit, komisarët i keni juve lart. Asnjë militant nuk mund të jetë më. Nuk mund të jetë auditues. Pra, në qoftë se do të punosh në shtet, puno në shtet. Bëj konkursin, futu në konkurs.

Fatmir Xhafaj – Po cili është propozimi, zotëri?

Eduard Halimi – Po pra, propozimi është: jo vetëm të mbajnë një mandat politik ata që janë zgjedhur në funksione drejtuese.

Fatmir Xhafaj – Mandat politik është.

Eduard Halimi – Këto po e po. deputet jo.

Fatmir Xhafaj – Po deputetit s'i lejohet, dihet.

Eduard Halimi – Të mos jetë anëtar i partisë, anëtar i organizatës bazë, sepse e keni mbushur me militantë. Hoqët nëntë mijë e i hodhët në rrugë dhe morët nëntë mijë militantë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Çdokush nga audituesit që ka pasur një mandat anëtarësie, duhet të largohet nga shërbimi urgjentisht. Rregullojeni këtë. me këtë rast, hiqni edhe nga 90% të atyre që kanë lënë këta, se i kanë pasur anëtarë të Partisë Demokratike.

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti zëvendësministër.

Erion Luçi – Edhe ky shqetësim parashikohet nga ligji i shërbimit civil, që nuk lejon edhe nivel më të ulët në parti, ose të jesh i përfshirë, që të hysh në shërbimin civil. Auditorët, automatikisht e kanë edhe këtë.

(Diskutim pa mikrofon)

Po pse e keni vënë këtë: “të jenë zgjedhur në funksionet drejtuese”? Pse e keni lënë?

Po të jesh anëtar i Partisë Demokratike bëhesh drejtor i bashkisë së Tiranës, e kupton? S'është ndonjë problem, sepse ai drejtori ashtu ishte. Muhabet kot tashti.

(Diskutim pa mikrofon)

Ju ka bërë Koçua të shikoni ëndrra, për Zotin! Bravo i qoftë! Koçua korri sukses në PD, s'e dija këtë. Do t'ju bënte Koçua të shikonit ëndrra! Edhe këtë s'e kisha menduar.

(Diskutim pa mikrofon)

Një Koço ju lëshuam dhe vrapuat. Keni humbur busullën dhe po shkoni pas Koços.

(Diskutim pa mikrofon)

Keni gjë tjetër?

(Diskutim pa mikrofon)

E pamë, si atë listën tuaj të 2013-ës, që ju fshiu të gjithëve. Bile më ka marrë malli për ca nga ata që kishit. Ishin nja dhjetë që i hoqi. S'keni më këtu. Ua futët atyre juve.

Po. Dakord.

Shikojeni këtë, se në fakt nuk ka kuptim.

(Diskutim pa mikrofon)

Funksionet drejtuese! Mandat politik! Është formulim parazitar ky. E di çfarë ishte kjo? Vetëm sa i dhatë mundësi që të kujtojë Koçon me mall.

(Diskutim pa mikrofon)

Unë Koçon në parti e kam.

Një Koço dhe ju hëngri. Hallall! Ma shtoi respektin Koçoja sot.

(Diskutim pa mikrofon)

18: “Konflikti i interesave”. Kthehemi te ligji ne.

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Fino, a të vazhdojmë me ligjin ne, se këta kanë ardhur për humor sot.

Neni 19.

Çfarë kishit ju për ligjin, zoti Fino?

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Pika 2 e nenit 19 duhet të hiqet, siç e biseduam edhe në nenin më përpara, ku bëhej fjalë se përplasej germa “c” me germën “ç”.

Fatmir Xhafaj – Po.

Bashkim Fino – Këtu thotë: “Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë vetëm ata të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 11”. Ata që kishin vetëm tre vjet pune dhe jo pesë vjet pune. Kjo më duket e pabarabartë, në sensin që, mbase duhet të hiqet. Propozimi që kam unë është që të shtohet edhe një germë tjetër, për certifikimin e audituesit; të regjistrohet në regjistrat kombëtar të audituesit, i cili duhet të mbahet nga ministri i Financave, gjë për të cilën duhet shtuar një pikë pesë.

Fatmir Xhafaj – Dakord? Dakord me shtesën?

Erion Luçi – Për këtë pjesën e të drejtës për të aplikuar vetëm nga struktura e brendshme, e gjithë ideja është që të ikim nga praktika aktuale. Në qoftë se ti do ta mbash strukturën prapë me prurje, ti do të certifikosh më shumë se sa struktura. Për t'i rënë shkurt, në përgjithësi e rrit shumë

numrin ose i jep të drejtën për të bërë atë që ndodhi deri tani, që janë certifikuar 1800, nga më pak se 400 që duhen. Kjo është një lëvizje pikërisht në drejtimin për të kufizuar këtë lloj prurjeje.

(Diskutim pa mikrofon)

Neni 19. Dakord me vërejtjet?

Neni 20. Dakord.

Neni 21. ”Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm, sipas ligjit ekzistues krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kurse sipas mendimit të propozuar të krijohet me urdhër të Ministrisë së Financave”.

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Në këtë dua sqarim. Në ligjin e mëparshëm, organizimi i komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm krijohet me vendim qeverie. Tani ti ma krijon me urdhër të brendshëm të ministrit. Ma ke ulur pjacën. Çfarë ka ndikuar që ti ma ul këtë gjë, kur në rastin konkret do të ishte mirë që edhe kjo të ishte me vendim qeverie?

Fatmir Xhafaj – Po vetvetiu do të vejë aty, sepse...

Bashkim Fino – Domethënë, pika 2 e nenit 21.

Fatmir Xhafaj – ...sepse 2-shi dhe 3-shi bien në konflikt me njëri-tjetrin. Ia ke lënë zotit zëvendësministër t’i japë pagën, por të mos t’i...

(Diskutim pa mikrofon)

Pse, kështu thua ti? Mënyra e organizimit, funksionimit, përbërjes dhe shpërblimit të anëtarëve, të caktohen me...

(Diskutim pa mikrofon)

Dakord?

(Diskutim pa mikrofon)

Shpërblimi shtesë. Jo paga.

(Diskutim pa mikrofon)

Po është shpërblimi, sepse këta nuk janë me kohë të plotë.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, dakord. dakord me ndryshimin në nenin 21

Neni 22. Edhe kjo duhet parë në raport me ligjin “Për nëpunësin civil”.

Te neni 22, pikat “a” dhe “b” duhet t’i shikoni sipas ligjit “Për nëpunësin e shërbimit civil”. Edhe raporti që do të dalë nga ne, duhet të dalë i përputhur me këto, Klodi. Në rregull?

Edhe “c”-në fuqizojeni!

Dakord me nenin 22, me sugjerimet e bëra nga relatori? Këshilltarët t’i zbardhin në formë drafti të propozuar dhe jo rekomandimi.

Neni 23: “Përgjegjësitë e ministrit të Financave”. Dakord?

Neni 24. Dakord.

Neni 25: “Marrëdhënia me Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Dakord.

Neni 26: “Nxjerrja e akteve nënligjore, tre muaj”. Dakord me nenin 26, me ndryshimet e bëra.

(Diskutim pa mikrofon)

Po.

Neni 27. Dakord.

Neni 28. Dakord.

Neni 29: “Hyrja në fuqi”. Dakord.

Në tërësi, kush është dakord? Kundër? S’ka. Abstenime? S’ka.

Miratohet edhe në tërësi.

Ju lutem, Klodi, së bashku me Ivën, për të dyja projektet reflektoni vërejtjet e sugjerimet që u bënë nga kolegët deputetë. Ato që do të paraqiten si propozime drejtpërsëdrejti për seancën nga Komisioni i Ligjeve, dhe ato që do t’i lihen Komisionit të Ekonomisë për të reflektuar, për shkak se është komision përgjegjës dhe i shikon nga këndvështrimi i fushës.

Zoti Zëvendësministër, ju faleminderit!

Faleminderit, gjithashtu, edhe juve që ishit me zëvendësministrin, zonjës Halili dhe zotit Meçe.

Gjithë të mirat! Punë të mbarë!

Takohemi nesër në orën 10. 00.

MBLEDHJA MBYLLET

